



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**  
**KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS ISHËM – ERZEN**

---

**VENDIM**

Nr. 5 datë 7.03.2014

Për

**Miratimin e lejës për përdorim teknologjik-ujitje të rezervës ujore me pus shpimi për subjektin “FU - FERRA”Sh.p.k, Linzë, Tiranë”.**

Në mbështetje të neneve 12, 41 pika 1 të Ligjit Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të vendimit nr.3 datë 19.07.2002 të K.K.U, “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit të Baseneve Ujëmbledhës dhe Agjensive të ujit”, të Vendimit Nr.1, datë 07.06.2007, të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për miratimin e formularit tip të lejes për “Përdorim të Rezervës Ujore”, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Ishëm-Erzen:

**V E N D O S I**

1. Miratimin e lejës për përdorim teknologjik-ujitje të rezervës ujore me pus shpimi për subjektin “Fu - Ferra”sh.p.k, Linzë, Tiranë.
2. Koordinatat e vendndodhjes të pusit:  
 $X = 45\ 80\ 350$        $Y = 44\ 06\ 100$        $Z = 338\ m$   
Thellësia e pusit të shpimit       $h = 100\ m.$
3. Sasia e ujit që jepet në përdorim       $Q = 0.2\ litër/sek$
4. Ngarkohet AUB Ishëm-Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËSIA U.B**  
**ISHËM – ERZEN**

**Shpëtim MEDIU**



**KRYETARI I K.B.U**  
**ISHËM - ERZEN**

**Sadi VORPSI**

